



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.4.2023,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti – Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Arben Kqira - udhëheqës i Zyrës ligjore dhe Granit Rugova - drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hap dhe e kryesoi Fehmi Kupina kryesues i komitetit, i cili paraqiti këtë

### REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31-mars 2023 (TM1);
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit „3x3 Prishtina Fiba Challenger”;
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Pro-Arte Institute;
5. Propozimvendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave „Prishtina”;
6. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së me nr.01-020/01-62792/22. dt.21.03.2022;
7. Propozimvendimi lidhur me Planin Komunal për Riintegrimin dhe Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riadhesuar dhe të Huajve në Komunën e Prishtinës 2023 - 2025;
8. Informatë lidhur me raportin tremujor janar – mars 2023 të Ndërmarrjes publike “Hortikultura”, SHA;

---

Faqe 1 nga 9

9. Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të „Ndërmarrjes Publike Banesore”, SHA;
10. Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike „Prishtina Parking”, SHA;
11. Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike „Pallati i Rinisë”, SHA;
12. Të ndryshme.

Para së të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

**Valbona Makolli** - tha se ka një propozim në emër të Kryetarit, lidhur me kërkesat e çerdheve me bazë në komunitet e që janë tetë (8) çerdhe, ku Drejtoria e Arsimit ka deklaruar që nuk ka subvencione për mbulimin e kësaj kërkesë dhe Kryetari ka shprehur gatishmërinë për përkrahjen e tyre.

**Nora Kelmendi** - tha se këto çerdhe që po kërkojnë mjete financiare, këto janë me bazë në komunitet, dhe e dimë se si janë formuar. Tutje pyeti se a raportojnë ndonjëherë se si po i shpenzojnë mjetet financiare, si dhe a kanë ndonjë raport financiar të gatshëm që ne ta analizojmë për asamble, kurse tha se edhe neve duhet të na raportojnë.

**Valbona Makolli** - tha se këto çerdhe i raportojnë direkt Drejtorisë së Arsimit, kanë raporte financiare, si dhe janë të audituar nga auditorët e brendshëm të komunës sikur çerdhet tjera.

**Jeta Rafuna** - tha se edhe vitin e kaluar kur e kemi ndarë një subvencion, jemi kuptuar që të jetë hera e fundit që i subvencionojmë pa na raportuar se çfarë po bëjnë me ato çerdhe dhe pa u formuar një komision i cili e mbikëqyr punën e tyre se si po funksionojnë ato, duke shtuar se nuk ka asnjë informacion lidhur me çerdhet.

**Gëzim Sveçla** – duke ju referuar drejtoreshës, tha se nëse i raportojnë Drejtorisë së Arsimit, përse nuk po ua siguron Drejtoria e Arsimit mjetet.

**Valbona Makolli** - tha se kanë planifikuar për diçka tjetër dhe kërkesa ka ardhur pasi që ka hyrë në fuqi ligji për pagat.

**Gëzim Sveçla** - tha se Komuna e Prishtinës e ka një rregullore për subvencionet, kur kemi të bëjmë me OJQ-të është Ligji për financa publike, janë disa kritere që duhet të plotësohen, janë disa dokumente që duhet t'i shohim ne si asamble për çdo vendim që votojmë, kurse tha se është vonë sot për t'na e sjellur kështu që duhet të shkojë për seancën e radhës.

**Valbona Makolli** - dha sqarime shtesë lidhur me subvencionimin e çerdheve.

**Gëzim Sveçla** - tha se duhet të kompletohet dokumentacioni bashkë me raportet për shpenzimet e subvencionimit e kaluara që i kemi bërë dhe të vjen në një seancë ku mundemi t'i analizojmë këto sepse po flasim për 100 e diçka mijë euro.

**Donjeta Dragusha** - tha se për këto çerdhe sa e di unë gjysma financohen nga pagesat, pra kanë të hyra vetanake e kështu që duhet të kemi një raport më të detajuar se çfarë po bëjnë me të hyra dhe çfarë po bëjnë me subvencionin që e jep komuna çdo muaj, në mënyrë që të kemi mundësi t'i subvencionojmë prapë për paga.

**Bahri Gashi** - tha se këto çerdhe janë të mira dhe e di që një pjesë të parave ua japim ne, por këto funksionojnë si biznese. Mirë është të shohim se si po i menaxhojnë ata dhe a kanë kapacitet të menaxhojnë (ndoshta kanë nevojë për përkrahje menaxheriale). Tutje tha se jam i pajtimit për t'ju ndihmuar, por vetëm është mirë me pa se pse ka ardhur deri të ndihma, të kemi një raport se ku po i lënë paratë, sa para i marrin në muaj dhe sa paguajnë ata fëmijë.

**Leutrim Retkoceri** - pyeti a ka raport të auditimit, të auditorit të brendshëm, nëse po, a mund ta sjellin atë raport në seancë. Pastaj tha se çerdhet me bazë në komunitet janë mbi 8 apo 9 vite që funksionojnë, nëse nuk funksionojnë kështu, si do të funksionojnë. Tutje tha se pajtohet plotësisht që duhet të ketë transparencë, por duhet të vijë raporti dhe nëse është dyshimi që 1 cent po keqpërdoret dikush duhet të jap përgjegjësi.

**Gëzim Sveçla** - tha se ndoshta zgjidhja është rritja e çmimit për ata fëmijë që i dërgojnë, po ashtu tha se duhet raport financiar për ne që japim para, jo vetëm raporti i auditimit sepse ne japim para, Kuvendi jep para, duhet edhe raport i brendshëm financiar i tyre, jo vetëm auditimi, sepse auditimi bëhet në bazë të mostrës dhe nuk ta jep një pasqyrë reale.

**Leutrim Retkoceri** - tha se nëse është mundësia në seancë unë jam pro kësaj për me pas mundësi me shpejtuar edhe nëse nuk mbërrim ta lexojmë gjithë raportin, e lexojmë për mbledhjen e ardhshme dhe nëse ka avari, e fusim si pikë të rendit të ditës dhe e ftojme dikë për të raportuar se si po shkojnë këto punë, apo si është bërë realizimi (mund t'i thërrasim edhe përgjegjësit këtu që janë).

**Valbona Makolli** - dha sqarime shtesë.

**Jeta Rafuna** - tha se duhet t'na sillat sot raporti financiar i auditimit.

**Valbona Makolli** - tha se raportin e auditimit nuk e di, raportin financiar besoj se duhet ta kenë sepse nuk munden tash për tash ta bëjnë, unë e di raporti i auditimit është bërë, por për çfarë periudhë kohore nuk e di.

**Nora Kelmendi** - pyeti se a kemi të drejtë ligjore t'i subvencionojmë për paga, për rritje të pagave.

**Gëzim Sveçla** - tha se është vendimi i vitit 2014 për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve dhe është për secilën drejtori si janë subvencionet, po ashtu tha në faqen e dytë të këtij materiali që na keni dërguar janë të hyrat mujore, totali i pagave mujore dhe bruto, d.m.th të hyrat po paraqesin sa kushtojnë pagat dhe sa po ju nevojiten për rritje të pagave. Lidhur me këtë pyeti drejtoreshën se a rrite komuna paga, a ka bazë ligjore komuna me rritë paga.

**Valbona Makolli** - tha se këtë nuk e di.

**Bahri Gashi** - tha se çka do të ndodhë mbas dymbëdhjetë (12) muajve. Çka nëse i subvencionojmë pagat për 12 muaj, çka pastaj. Këtu ka ndikuar nivelizim i pagave dhe me të drejtë, ndoshta i kanë pagat e vogla dhe nëse është pengesë vetëm ky nivelizim na duhet t'ju japim para për t'ju ndihmuar të punojnë dhe mos t'i lëmë pa punë. Në fund pyeti drejtoreshën pse për dymbëdhjetë (12) muaj dhe çka pas dymbëdhjetë (12) muajve, a nuk mundet kjo të rregullohet përgjithnjë.

**Valbona Makolli** - dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara.

**Gëzim Sveçla** - kërkoi sqarime nga Zyra ligjore.

**Arben Kqira** - tha se nuk e di çfarë statusi kanë punëtorët e çerdhes nëse janë zyrtarë publikë, atëherë kjo nuk është kompetencë e komunës, na i japim subvencion çerdhes e pastaj menaxhimenti i tyre vendos çka bënë me atë subvencion.

**Gëzim Sveçla** - tha se ata në kërkesë e kanë specifikuar për paga.

**Nora Kelmendi** - tha se kërkesën e kanë për rritjen e nivelit të pagave.

**Arben Kqira** - tha se beson se nuk ka asgjë të paligjshme këtu, vetëm nëse janë punëtorë të DKA –së, atëherë nuk lejohet.

**Gëzim Sveçla** - pyeti cila është baza ligjore, në çka mbështetet ai vendim.

**Arben Kqira** - dha sqarim për pyetjen.

**Donjeta Dragusha** - pyeti drejtoreshën a ka ndonjë person përgjegjës në DKA, zyrtar që i mbikëqyr këto çerdhe, dhe prej subvencionit aktual që ju bënë komuna, a i paguan pagat.

**Valbona Makolli** - dha sqarime për pyetjen.

**Fehmi Kupina, Kryesues** - tha nëse kompletetohet materiali, nëse e sjellin sot raportin komplet pajtohem që ta fusim në rend dite, nëse jo të mbetet për mbledhjen e majit.

**Gëzim Sveçla** - tha se ajo që është e rëndësishme është të ketë bazë ligjore.

**Granit Rugova** - kërkoi të hynë si pikë e rendit të ditës përkrahja e 7 klubeve tjera të sportit të Prishtinës, është ekziston dhe kërkesat janë të bashkangjitura aty.

**Gëzim Sveçla** - tha se është e pamundur të shikohen këto raporte për dy ditë deri në seancë.

**Donjeta Dragusha** - tha se këto klubet që janë përkrahur a kanë bërë ndonjë raport financiar si i kanë shfrytëzuar mjetet në vitin e kaluar.

**Jeta Rafuna** - pyeti drejtorin pse në momentet e fundit po dërgon kërkesë për subvencion dhe siç duket janë të njëjtat klube që i kemi subvencionuar vitin e kaluar. Vitin e kaluar kam pasur një kërkesë m'u zgjeruar edhe këto sportet tjera, kishte qenë mirë edhe ne me pas njëfarë informate për kërkesat.

**Granit Rugova** - dha sqarime për çështjet e parashtruara.

**Leutrim Retkoceri** - tha se sa i përket kërkesës së parë për çerdhet me bazë në komunitet mos të vjen as në seancë se ideja është me përgatit komplet materialin, e sa i përket përkrahjes se klubeve të sportit është votuar edhe herën e kaluar dhe çështja është te subvencionimi që qenkan gjet mjetet dhe klubet duhet të përkrahen, kurse në fund tha se pajtohet që materialet duhet me ardhur me kohë në KPF.

**Bahri Gashi** - tha se i pëlqen që qenkan tri klube të femrave që po subvencionohen dhe i përkrah, por raportet është t'i sjellin me kohë.

**Gëzim Sveçla** - tha se problemi është te procedurat që nuk na ka ardhur si material, me pas raport si janë shfrytëzuar ato mjete, andaj kërkoi të përgatiten dokumentet krejt siç duhet, pastaj thirrni seancën tjetër dhe i kalojmë.

**Donjeta Dragusha** - pyeti si po zgjidhen këto klube, çfarë kriteret po përdoren për përzgjedhje dhe shuma qysh po i përcaktojnë a janë në këto kërkesa. Po ashtu tha për këto që i kemi subvencionuar më herët kishte qenë mirë me pas një raport dhe këto që i subvencionojmë për herë të parë me pas një plan qysh po dëshirojnë t'i shpenzojnë.

**Granit Rugova** - tha se kërkesat për çka po i kërkojnë, ku do t'i harxhojnë mjetet janë në secilën kërkesë të tyre.

**Fehmi Kupina, Kryesues** - tha se i përkrah dy propozimet me dokumente shtesë.

**Nora Kelmendi** - tha se i përkrahin me dokumente shtesë.

**Leutrim Retkoceri** – ceku si njoftim për një pikë shtesë në lidhje me vendosjen e një pllake përkujtimore që është si kërkesë që ka qenë nga Shoqëria „Lëvizja Pranvera Shqiptare 81” për protestat e vitit 1981. Aty tek Mensa e studentëve është vendosur gurthemeli, e cila është votuar në 2021, mirëpo është kthyer nga MAPL – ja për mangësi të kompletimit të kërkesës. Në fund tha se kisha propozuar që e njëjta të hyjë në rend dite, materialet janë të njëjta dhe nevojitet vetëm të përmirësohet kërkesa pasi që i është referuar dispozitave gabim dhe kjo ka qenë arsyeja që është kthyer nga MAPL – ja.

**Milazim Vitija** - tha vetëm ato dispozita duhet të rregullohen.

## **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

## **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31 - mars 2023 (TM1)**

**Valbona Makolli** - tha se prej KPF –së po pres deri të premtën mos kanë ndonjë sugjerim, vërejtje dhe pastaj i procedojmë.

**Donjeta Dragusha** - kërkoi sqarime nga drejtoresha se çka është kjo licenca në biznes dhe çka është kjo rritje qaq e madhe. Po ashtu pyeti te rritja e shpenzimeve te pagat a e ka ndryshuar Ligji për paga, apo mbetet ai që e kemi votuar, si dhe pyeti te tabela e investimeve kapitale projektet që janë në vazhdimësi që janë nga viti 2022, këtu përfshihet vetëm buxheti 2023 me atë bartjen që e kemi nda.

**Valbona Makolli** - dha sqarime për pyetjet e parashtruara.

**Leutrim Retkoceri** - tha se me rëndësi ta vëmë në theks para seancës të hyrat nga tatimi në pronë për shkak të vendimit që është hiç kushtëzimi, komuna do të ketë problem në grumbullimin e të hyrave vetanake, kure është mirë në këtë drejtim të bëhet digjitalizim për të marrë të hyra se për momentin është më pak se 20%, dhe sa për informim se këtë vit është realizuar vlera më e ulët e subvencionimit për tre mujorin e parë në 43% në bazë të tabelës. Në fund ai ceku amullinë e krijuar tek qytetarët për faljen apo mosfaljen e borxhit dhe shtoi se ka qenë mirë të krijohet kampanjë për informim të qytetarëve rreth kësaj çështjeje.

**Valbona Makolli** - tha se si drejtori që e menaxhon tatimin në pronë ne i kemi dhënë komentet tona lidhur me draftin i cili ka shkuar në Kuvend, nuk e di a merren parasysh, por kemi kërkuar një udhëzim administrativ nëse përkrahet ai projektligj i ndryshimeve që nuk pajtohem normal si drejtori për arsye se nuk e ka mënyrën e zbatueshmërisë dhe si do të bëhet si zbatueshmëri. Ajo ceku edhe takimin me asociacionin e komunave dhe mospajtimin e komunave lidhur me çështjen, kurse tha se nuk e dimë si të veprojmë pasi deri tani nuk kemi përgjigje dhe ende po presim.

**Nora Kelmendi** - pyeti drejtoreshën për të hyrat e „Hortikulturës” pse nuk janë pasqyruar në tabela që i ke në raport financiar e këtu në informatë i kemi të hyrat janë të pasqyruara.

**Valbona Makolli** - dha sqarime për pyetjen e parashtruar.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 janar 31 - mars 2023 (TM1) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit „3x3 Prishtina Fiba Challenger”**

Lidhur me Propozimvendimin për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit „3x3 Prishtina Fiba Challenger” në pika të shkurtra informoi **Granit Rugova**, drejtor.

**Gëzim Sveçla** - tha se e përkrahin organizimin e një aktiviteti të tillë, por i kemi disa pikëpyetje të cilat besoj do t'i sqarojmë deri para seancës në mënyrë që të jemi krejt në rregull, d.m.th. kjo „3x3” është OJQ, dhe për këtë njëjtë sa i përket subvencionimit vjen në shprehje Ligji për financat publike, në ç' rast tregon se nuk mundesh me marrë subvencione dy herë prej mjeteve të shtetit, kurse prej informatave që i kemi, ky aktivitet „3x3” do të subvencionohet nga Ministria e Financave për të njëjtin aktivitet dhe nuk e kemi parë deklaratën e nënshkruar në dokumentacionin nga organizatori, parashtruesi i kërkesës që kërkesa e tyre e drejtuar komunës është vetëm për komunën dhe këto mjete do të shpenzohen për ato kërkesa që i kanë paraqit.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësi, sqarime dha **Granit Rugova**, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit „3x3 Prishtina Fiba Challenger” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Pro-Arte Institute**

Faqe5nga9

**Valbona Makolli** - tha se edhe kjo është një përkrahje nga subvencionet e kryetarit, si dhe është arsyetimi saktësisht për çka po kërkohen mjetet.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Pro-Arte Institute dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave „Prishtina”**

Lidhur me **Propozimvendimin për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave „Prishtina”** në pika të shkurtra informoi **Granit Rugova**, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave „Prishtina” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së me nr.01-020/01-62792/22. dt.21.3.2022**

**Lulzim Fushtica** - tha se kërkesa jonë ka të bëjë me kërkesën që ka ardhur prej Policisë së Kosovës për plotësimin-ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në bazë të Ligjit për Polici. Policia e Kosovës. Stacioni i ka krijuar dy Këshilla Lokal për Siguri Publike dhe i ka ndërruar dy kryesues të Këshillit Lokal për Siguri Publike, ashtu siç e kërkon ligji këta duhet të aprovohen në Kuvend.

**Gëzim Sveçla** - pyeti pse ndodh ky ndryshim, cila është arsyeja dhe a ka ndonjë filtrim që kalojnë këta.

**Lulzim Fushtica** - dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtuara nga parafolësi.

**Bahri Gashi** - tha se është mirë ne si asamblistë me pas një raport ose një procesverbal për dy takimet.

**Lulzim Fushtica** - tha se në muajin maj mbahet takimi i radhës, jeni të mirëseardhur dhe aty do ta paraqesim punën e KKSB-së,

**Milazim Vitija** - tha se nuk kanë përfaqësues në Mramor, Slivovë, Marec, Kukavicë, ato kanë mbetur pa përfaqësues.

**Lulzim Fushtica** - tha se Këshillat Lokal për Siguri Publike i krijon policia dhe jo komuna. Stacioni policor përkatës i krijon me vendim të drejtorit të policisë, me propozim të komandantit të policisë ose të komunitetit. Nëse komuniteti në fjalë ka nevojë, atëherë duhet të kontaktojë me stacionin policor përkatës dhe të bëjnë kërkesë dhe menjëherë krijohen KLSP, dhe ne si komunë i japim përkrahjen në çfarëdo mënyre, por ne nuk mund të krijojmë një trup të tillë.

**Leutrim Retkoceri** - tha mendoj se ka qenë shumë e nevojshme Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri dhe e përgëzoj.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së me nr.01-020/01-62792/22. dt.21.3.2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e shtatë**

### **Propozimvendimi lidhur me Planin Komunal për Riintegrimin dhe Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe të Huajve në Komunën e Prishtinës 2023 -2025**

**Kryesuesi** - tha se për këtë pikë është dashur me qenë Betim Abdullahu, por është jashtë shtetit.

**Fehmi Kupina, Kryesues** - konstatoi se u përkrah Propozimvendimi lidhur me Planin Komunal për Riintegrimin dhe Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe të Huajve në Komunën e Prishtinës 2023 -2025, dhe injëjti dërgohet në Kuvend për miratim.

## **Pika e tetë**

### **Informatë lidhur me raportin tremujor janar-mars 2023 të Ndërmarrjes publike „Hortikultura”, SHA**

**Shegë Beqiri** - tha se aksionarët e kanë dërguar raportin dhe nëse keni ndonjë ndryshim apo plotësim mundem t'ju dërgojë e-mailin dhe deri në seancë t'i bëjmë ndryshimet.

**Gëzim Sveçla** - tha se rreth 4 pikëve të radhës, pse janë informata e jo raporte a mundem me ditë, dhe viti fiskal ka përfunduar më 31 mars, pse nuk kemi një raport prej ndërmarrjeve publike komunale, por kemi një informatë.

**Bahri Gashi** - tha se mendon në seancë duhet të vijnë edhe drejtorët e jo vetëm aksionarët, sepse aksionarët nuk kanë të dhëna çka ne mund të interesohemi. NP „Pallati i Rinisë” dhe „Prishtina Parking” nuk kanë dërguar material, ndërsa NP „Hortikultura”, kishte bërë një raport të mirë, ndërkaq “Ndërmarrja Publike Banesore” ishte skandal. Po ashtu kërkoi nga kryesuesi që t'i përgatitin materialet siç duhet ose të largohen nga rendi i ditës pikat.

**Gëzim Sveçla** - tha se edhe ai propozon që të largohen nga rendi i ditës raportet e “Pallati i Rinisë” dhe „Prishtina Parking”.

**Bahri Gashi** – tha se të gjitha NP duhet të raportojnë në asamble sepse ne jemi pronarë ekskluziv të ndërmarrjes, kurse 17 muaj ne nuk kemi parë asnjë raport nga asnjë NP. NP duhet të sjellë raport vjetor se çfarë kanë bërë, ku i kanë marrë mjete dhe ku i kanë harxhuar

**Jeta Rafuna** - tha se „Pallati i Rinisë” ka raportuar vitin e kaluar.

**Fehmi Kupina, Kryesues** - tha se të gjithë do t'i keni në seancë edhe kryeshefat dhe mund t'ju drejtoheni atyre.

**Gëzim Sveçla** - tha nuk është çështja që kryeshefi duhet ta bëjë raportin, por ju kryesues dhe Kryetari duhet të kërkoni që KPF-ja po kërkon që këto ndërmarrje të sjellin raporte, sepse unë nuk mundem e as kolegët të shkojmë e të kërkojmë raport nga kryeshefi, pasi që është çështje institucionale.

**Leutrim Retkoceri** - lidhur me raportin për NP „Hortikultura” tha se janë dy premisa, raportimi në bazë të informatave, raportimi në bazë të një plani të biznesit dhe raporti pas publikimit të raportit të auditimit. Në fund tha se Sa i përket heqjes së pikave të rendit të ditës unë nuk jam pro, unë jam për të futur sa më shumë pika.

**Bahri Gashi** - tha kërkoj rekomandim që raportet e ndërmarrjeve publike t'i fusim aty.

**Donjeta Dragusha** - tha se këto informata nuk është mirë të largohen nga rendi i ditës pasi që marrin një informatë sadopak për gjendjen aktuale. Ajo çka mund të kërkojmë për një periudhë të shkurtër, është të marrim raportet e auditimit dhe t'i fusim në një pikë të rendit të ditës për raportim të ndërmarrjeve.

**Bahri Gashi** – tha, unë kërkoj raport financiar për çdo cent se si ka hyrë dhe ku kanë shkuar dhe kjo më intereson jo raporti i auditimit.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah >Informata lidhur me raportin tremujor janar – mars 2023 të Ndërmarrjes publike „Hortikultura”, SHA< dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### **Pika e nëntë**

**Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të „Ndërmarrjes Publike Banesore”, SHA**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah >Informata lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të „Ndërmarrjes Publike Banesore”, SHA< dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### **Pika e dhjetë**

**Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”, SHA**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah >Informata lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike „Prishtina Parking”, SHA< dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike „Pallati i Rinisë”, SHA**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah >Informata lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike „Pallati i Rinisë”< dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### **Të ndryshme**

**Gëzim Sveçla** - pyeti drejtorin Lulzim Fushtica, për lirin në shesh që është prerë.

**Lulzim Fushtica** - tha se është raporti për vlerësimin që është bërë nga Sektori për emergjenca dhe ka qenë rrezik për qytetarët në bazë të ankesave të tyre.

**Gëzim Sveçla** - tha se a jeni në dijeni se ka edhe metoda të tjera se si bëhet sigurimi i lisave në raste të tilla.

**Lulzim Fushica** - tha se janë në dijeni, por lisi në fjalë ka qenë shumë i dëmtuar.

**Nora Kelmendi** - shprehu shqetësimin për pyetjet që ia drejtojnë drejtorëve, por nuk marrin asnjëherë përgjigje dhe ju drejtohen se nëse nuk kanë mundësi të përgjigjen në seancë, atëherë përmes e-mailit t'ju përgjigjen, por ata nuk e bëjnë këtë. Ajo kërkoj nga kryesuesi që t'ju thotë, që ata t'ju përgjigjen pyetje që i parashtrajnë.



**Fehmi Kupina, Kryesues** - tha se kam kërkuar nga drejtorët që nëse nuk kanë mundësi të qëndrojnë në seancë, së paku të përgjigjen përmes e-mailit.

**Bahri Gashi** - tha se nuk po i shkon e-maili i KPF-së asnjëherë.

**Gëzim Sveçla** - kërkoj që t'ju rritet hapësira në email-in zyrtar.

**Mirsad Vitia** - pyeti se a ka parking komuna për asamblistët.

**Fehmi Kupina, Kryesues** - sugjeroi që t'i drejtohet drejtorit Bersant dhe të marrë lejen e veçantë dhe duhet t'i dërgojnë targat.

**Gëzim Sveçla** - kërkoj që kjo kërkesë të bëhet për të gjithë asamblistët.

**Bahri Gashi** - tha se ju takon asamblistëve t'ju bëhet leje e veçante sa të kenë mandat.

**Gëzim Sveçla** - tha se pa rregullore kjo nuk funksionon.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina**

